

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË** –Departamenti për Krime te Rënda Gjyqtari Shaqir Zika, Kryetari i Trupit Gjykues, dhe gjyqtareve Myfera Hoxha, dhe Manduhije Sylja, anëtare të Trupit Gjykuese me pjesëmarrjen procesmbajtëses Bute Ramosaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit E. P. P., nga fshati Q., K- Gjakovë, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupore nga neni 188 par.2 lidhur me par 1 të KPK-së, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë së Qarkut në Pejë, tani Prokuroria Themelore ne Gjakove,- Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.68/2004, datë 17.02.2004, dhe dt. 17.02.2004, pas mbajtjes se seancës së shqyrtimit kryesorë, të mbajtur më datën 17.10.2016, me pjesëmarrjen e Prokurorit te Shtetit te PTH ne Gjakovë Ali Uka, i akuzuarit E. P., dhe mbrojtësit te tij av. E. B. nga Gjakove, i dëmtuari Gj. M., marrë dhe të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

**I akuzuari: E. P.**, i lindur me ..., në fshatin Q. K- Gjakove, ku dhe jeton, nga i ati P. dhe ëma T., e gjinisë P., i martuar, i ati pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i R. së Kosovës.

## REFUZOHET AKUZA

**I.** Me dt. 25. Janar 2004, rreth orës 16:00, në mal të fshatit L. K- Gjakovë, me dashje ka tentuar ta privoi nga jeta Gj. M. të moshës 26 vjeçar, bujk nga fshati B. K- Gjakovë, në atë mënyrë që për shkak të mosmarrëveshjes të tyre të mëparshme dhe fjalosjes së paraqitur ditën kritike i pandehuri E. P. ka nxjerrë revolen nga brezi te kali. 9mm, me numër serik U100492 dhe prej një largësie të pa caktuar ka shtënë në drejtim të tani të dëmtuarit Gj. M., duke e goditur në dorën e djathtë, duke i shkaktuar dëmtim të lehtë trupor ku pastaj si rast urgjent është dërguar më spital për të dhënien e ndihmës mjekësore.

**-me çka kishte për të kryer veprë penale lëndim i lehtë trupore nga neni 188 par.2 lidhur me par 1 të KPK-së,**

Shpenzimet e procedurës penale bije ne llogari të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

## Arsy etim

Prokuroria e Qarkut në Pejë tani Prokuroria Themelore ne Gjakove, - Departamenti për Krime të Rënda, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.68/04, te dt. 17.02.2004, kundër të akuzuarit E. P., nga fshatin Q. K- Gjakove, për shkak të veprës penale, të vrasje në tentativë nga neni 30 al. 1. të LPK-se, lidhur me nenin 19 te LPJ-se, dhe veprën penale, mbajtje në pronësi, kontroll ose në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve, nga neni 328 par.1. te KPK-se.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë PAKR.nr. 899/2012, te dt. 16.04.2013, është aprovuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit E. P., dhe sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, P.nr. 154/2010, te dt. 20.10.2011, është anuluar dhe çështje penale i është kthyer të njëjtës Gjykatë në rigjykim.

Gjykata Themelore ne Gjakove – Departamenti për Krime te Renda, ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesore me dt. 17.10.2016, ku prezentë ka qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shteti Ali Uka, i akuzuari E. P., se bashku me av. E. B., i dëmtuari Gj. M., si dhe dëshmitari M. M.

I dëmtuari Gj. M., ne fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se ndaj të akuzuarit nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike- te akuzuarit rastin ja ka falur dhe janë pajtuar sipas traditave zakonore.

Gjykata ka zbatuar procedurën e provave ka vepruar sipas vërejtjeve të Gjykatës së Apelit, janë proceduar i dëmtuari, janë lexuar deklarata e dëshmitarëve është marrë ne pyetje ekspertit mjeko-ligjore, dr. F. B., si dhe ekspertit i balistikës I. K., ka dhenë mbrojtje i akuzuari dhe përfaqësuesi i akuzës në fjalën e tij përfundimtare ka bërë rikualifikimin nga vepra penale e tentim vrasje nga neni 30 al. 1 te LPK-se, lidhur me nenin 19 te LPJ-se, ne vepër penale lëndimi i lehte trupore nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1 te KPK-së, ndërsa për vepër penale mbajtje në pronësi, kontroll ose ne shfrytëzim të pa autorizuar te armëve nga neni 328 par.1 te KPK-se, ka mbetur në fuqi aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, P.nr. 154/2010, më të cilin aktgjykim është shqiptuar dënimi më gjobë.

Prokurori i Shteti Ali Uka, ne fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar së: gjatë këtij shqyrtimit gjyqësore verbale- publikë, administrimit të të gjitha provave duke vepruar sipas vërejtjeve të Gjykatës së Apelit, dëshmisë së dëmtuarit Gj. M., dhe dëshmisë së dëshmitarit M. M., nga dëshmia e eksperteve mjeko-ligjore dr. F. B., te dhënë në këtë shqyrtim gjyqësore, ku është konstatuar se në rastin konkrete kemi të bëjë me dëmtime të lehtë trupore, dëshmisë se ekspertit të balistikës I. K., si dhe provat materiale të cilat u administruan gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor deklaroi se këtu nuk kemi të bëjë me vepër penale tentim vrasje nga neni 30 al.1 te LPK-se, lidhur me nenin 19 te LPJ-se, por kemi te bëjë më vepër penale lëndimi i lehtë trupore nga neni 188 par. 2 lidhur me par 1 te KPRK-se, andaj duke qenë se vepra penale e kryer me dt. 25.01.2004, dhe se dënimi i kanosur për këtë vepër penale është gjerë në 3 vite, andaj deklaroi se heqë dore nga aktakuza përket vepër penale për shkak te parashkrimit absolut te veprës penale, ndërsa sa i përket veprës penale mbajtje ne pronësi, kontroll posedim ose ne shfrytëzim të armës nga neni 328 par. 1 te KPRK-se, mbetet në tërësi aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë. Meqenëse Gjykata e Apelit të njëjtin e ka lënë në fuqi.

Pasi qe Prokurori i Shtetit ne fjalën e tij përfundimtare ka bërë rikualifikimin nga vepra penale e tentim vrasjes, nga neni 30 al. 1, te LPJ-se, lidhur me nenin 19 te LPJ-se, dhe ne rastin konkret ka ardhur gjerë të parashkrimi absolut i ndjekjes penale, andaj

gjkata ne baze te dispozitave te nenit 363/1, pika 1.3 te KPPK-se, ka vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykim.

Ne baze te dispozitave te nenti 450 parq.1 pika 7 te KPPK-së, është vendosur që shpenzimet e procedurës penale te bije ne llogarit te mjeteve buxhetore te kësaj gjykate.

**GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË,-Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr. 317/13, dt. 17.10.2016**

**Procesmbajtësja  
Bute Ramosaj**

**Kryetari i trupit gjykues  
Shaqir Zika**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër ketij aktgjykimi mundë të ushtrohet ankesë ne afate prej 15 ditëve nga dita e pranimit nëpërmjet kësaj gjykate për gjykatën e Apelit në Prishtinë.